



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare / Ministarstvo Rada,
Porodice i Vrednosti Oslobodilačkog Rata / Ministry of Labor, Family and Values of
the Liberation War



Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/Central Labour Inspectorate

02V-20-26/1426

25.03.2026



Inspektori i Punës [REDACTED], bazuar në dispozitën e nenit 2 dhe 5 të Ligjit nr.2002/9 dhe Ligjit nr.03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ligji për Inspektimet Nr.08/L-067 neni 21 dhe neni 25, dispozitën e nenit 2 paragrafi 1, neni 82 dhe neni 94 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, Ligji nr.08/L-283 për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin nr.05/L-087 për Kundërvajtje, dispozitën e nenit 44, neni 47, neni 97 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, procesverbalit i inspektimit 02-20-26/1426, të dt.03.03.2026, dhe procesverbalit të ri-inspektimit 02-20-26/1426A, të dt.11.03.2026, lidhur me ankesën me nr.22/26, të datës 30.01.2026, palës ankuese [REDACTED] ndaj Ndërmarrjes “Trepça” SH.A., Mitrovicë, me datën: 25.03.2026 nxjerr:

V E N D I M

Përfundon procedura administrative lidhur me parashtresën nr. 22/26, të dates 31.01.2026; nuk janë gjetur shkelje të dispozitave ligjore në marrëdhënien e punës, lidhur me vendimin e Komisionit Disiplinor nr.88/26, të dates 06.01.2026, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të paraqitur nga pala ankuese [REDACTED] punonjëse në Ndërmarrjen „Trepça” SH.A., në IQP-në në Mitrovicë, kundër Ndërmarrjes “Trepça” SH.A. në Mitrovicë, me njoftimin e këtij akti administrativ.

A r s y e t i m

Inspektorët e Punës [REDACTED], me [REDACTED] dhe [REDACTED], me [REDACTED] të autorizuar sipas dispozitave të nenit 82 paragrafi 1, nenit 92 dhe neni 94 të Ligjit nr. 03/L-212 për Punën, si dhe sipas dispozitave të neneve 1, 2 dhe 5 të Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ligjit nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, Ligjit nr. 08/L-283 për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, si dhe Ligjit nr. 08/L-067 mbi Inspektimet, konstatojnë këtë gjendje faktike:

Më datë 03.03.2026 është kryer inspektim sipas ankesës nr. 22/26 të datës 30.01.2026 ndaj Ndërmarrjes “Trepça” SH.A., me adresë: Parku Industrial, Mitrovicë, në çështjen administrative

të palës ankuese [REDAKTUAR], e punësuar në Ndërmarrjen “Trepça” SH.A. Pala ankuese ka parashtruar ankesë kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 06.01.2026, me nr. protokollit 88/26, me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore – ndërprerje e marrëdhënies së punës.

Pala ankuese i është drejtuar Inspektoratit të Punës – Mitrovicë me ankesë kundër Ndërmarrjes “Trepça” SH.A., Mitrovicë, duke kundërshtuar në tërësi Vendimin nr. 88/26, si të pabazuar në fakte, të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin. Në ankesë, pala ankuese [REDAKTUAR] pretendon se vendimi në fjalë është i pabazuar në prova faktike dhe se ushtrimi i së drejtës për shprehje nuk përbën shkelje disiplinore.

Po ashtu, pala ankuese deklaron se asnjëherë nuk ka tejkaluar kompetencat e saj dhe se, para çdo komunikimi publik, ka kërkuar miratim nga Kryeshefi Ekzekutiv. Sipas saj, për këtë ekzistojnë dëshmi në formë të kërkesave të dërguara përmes emailit, të cilat, sipas pretendimeve të saj, janë refuzuar nga Kryeshefi Ekzekutiv. Gjithashtu, pala ankuese deklaron se nuk ka pranuar ftesë për t’u paraqitur pranë Komisionit Disiplinor.

Lidhur me këtë ankesë, inspektorët e punës kanë dalë në inspektim dhe kanë hartuar Procesverbalin e Inspektimit nr. 02-20/26/1426, të datës 03.03.2026, në Ndërmarrjen “Trepça” SH.A., në Parkun Industrial në Mitrovicë. Procesverbali është hartuar në praninë e zyrtares së Burimeve Njerëzore, znj. [REDAKTUAR], ku janë lënë obligime për prezantimin e dokumentacionit nga marrëdhënia e punës lidhur me ankesën e palës ankuese, si në vijim:

1. Kontrata e punës
2. Njoftimi për t’u paraqitur para Komisionit Disiplinor
3. Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës
4. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës
5. Çdo material tjetër lidhur me shqiptimin e masës disiplinore që kontribuon në arsyetimin e vendimit për shkëputjen e marrëdhënies së punës.

Përmes emailit nga Burimet Njerëzore të Ndërmarrjes “Trepça” SH.A., është dërguar dokumentacioni i kërkuar sipas procesverbalit të datës 03.03.2026, nr. 02-20-26/1426, si në vijim:

1. Kontrata e punës për [REDAKTUAR], me pozitë (Asistente e drejtorit, zyrtare e mediave në Flotacion)
2. Vendimi nr. 88/26 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës
3. Procesverbali i Komisionit Disiplinor të datës 06.01.2026, me nr. 87/26
4. Ftesa për pjesëmarrje në seancën disiplinore të datës 06.01.2026, si dhe emaili i dërguar palës ankuese lidhur me këtë ftesë
5. Vendimi mbi largimin e përkohshëm nga puna me nr. 9745/25, i datës 24.11.2025
6. Vendimi nr. 9725/25 i datës 21.11.2025, si dhe dëshmi të prononcimeve të palës ankuese në media dhe postime në rrjete sociale.

Me rastin e riinspektimit është shqyrtuar dokumentacioni i prezantuar nga Burimet Njerëzore të Ndërmarrjes “Trepça” SH.A., si dhe dokumentacioni i prezantuar nga pala ankuese, lidhur me

procedurën se si ka ardhur deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës për palën ankuese [REDAKTUAR]

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur është konstatuar se procedurat janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe rregulloret e brendshme të Ndërmarrjes "Trepça" SH.A., pasi që, sipas Komisionit Disiplinor, pala ankuese ka cenuar rregulloret e brendshme të ndërmarrjes.

Sa i përket vendimmarrjes për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga Komisioni Disiplinor, Rregullorja për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të Punëtorëve të Ndërmarrjes "Trepça" SH.A., në nenin 10 paragrafi 2, shprehimisht përcakton: "Për shkelje të rënda të detyrave të punës vendos Komisioni Disiplinor".

Inspektori i Punës në Mitrovicë – si organ i shkallës së parë, [REDAKTUAR], ka shqyrtuar në tërësi ankesën nr. 22/26 dhe pretendimet e paraqitura nga pala ankuese, tash ish-punonjëse në Ndërmarrjen "Trepça" SH.A., [REDAKTUAR]. Në bazë të dokumentacionit të administruar nga pala ankuese dhe dokumentacionit të prezantuar nga Burimet Njerëzore të Ndërmarrjes "Trepça" SH.A., nuk janë vërtetuar shkelje të dispozitave ligjore dhe rregulloreve në fuqi nga ana e Komisionit Disiplinor të Ndërmarrjes "Trepça" SH.A.

Për rrjedhojë, nuk janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore nga marrëdhënia e punës lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Sa i përket kontestimit të ndonjë prove nga ana e palës ankuese, ajo ka pasur mundësi të iniciojë kontest gjyqësor pranë gjykatës kompetente, sipas këshillës juridik të dhënë në Vendimin nr. 806/26 të datës 27.01.2026, të nxjerrë nga Komisioni i Ankesave në Ndërmarrjen "Trepça" SH.A., lidhur me ankesën e palës [REDAKTUAR] me nr. 315 të datës 13.01.2026.

Me datën 12.03.26, në zyrat e IQP-ës në Mitrovicë është pranuar nga pala ankuese [REDAKTUAR] shkresa me nr. prot 76/26, (Kundërshtim ndaj procesverbalit të riinspektimit të datës 11.03.2026), mirpo nga shiqimi i saj nuk kemi vrejtur ndonje rrethan te re e cila do te ndikonte ne ndryshimin e konstatimit e procesverbalit të datës 11.03.2026.

Andaj, lidhur me pretendimet e palës ankuese, kemi vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Punëdhënësi mbetet i obliguar të vazhdojë respektimin dhe zbatimin e dispozitave të ligjeve në fuqi.

Ky vendim është përpiluar në ekzemplarë të mjaftueshëm identik; nga një (1) ekzemplar i dorëzohet palëve, ndërsa ekzemplarët tjerë Inspektori i Punës i mban për procedurë të mëtejshme.

Data: 25.03.2026

Mitrovicë.

INSPEKTORI I PUNËS
[REDAKTUAR]

Pasi që nuk kemi adresë të palës ankuese, ky vendim do ti dërgohet përmes email adresës që është ankuar në Inspektoriatin Qendror të Punës

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 30 ditësh, pas marrjes të këtij vendimi, lejohet ankesa në Komisionin e Ankesave në Ministrinë për Punë, Familje dhe Vlera të Luftës Çlirimtare, nëpërmes Inspektorit të Punës në Mitrovicë, Rruga: "Afrim Zhitia", (Objekti i Administratës Pensionale) kati II, zyrja nr.34. Mitrovicë.